

## WUS Austria Prishtina Office Media Report 2008

**06.09.2008**

Koha Ditore - "Austria ndihmon UP – në me pesë projekte ne tre vjetët e ardhshme"

English translation: Austria helps UP with 5 projects for the next three years

Zëri - "WUS – Austria lanson edhe pesë projekte për arsimin e lartë në Kosovë"

English translation: WUS – Austria launches five more projects for the Higher Education in Kosova

Express - "Mbështetje për pesë projekte"

English translation: Support for five projects

Kosova Live - "WUS Austria financon 5 projekte në Universitetin e Prishtinës"

English translation: WUS – Austria launches 5 projects at the University of Prishtina

**18.07.2008**

Info Press - "Austria i "zgjat dorën UP -së"

English translation: Austria helps UP

Bota Sot - "Austria ndihmon UP –në me 883 000 Euro"

English translation: Austria helps UP with 883 000 Euro

Zëri - "Austria i jep edhe një ndihmë arsimit të lartë në Kosovë"

English translation: Austria assists again the Higher Education in Kosova

KOHA Ditore - "Mbi 800 mijë euro për Universitetin e Prishtinës"

English translation: Over 800 thousand Euro for the University of Prishtina

Kosov Sot - "Austria I jep UP – së mbi 800 mijë euro"

English translation: Austria assists UP with over 800 thousand Euros

Lajm - "Austria Vazhdon ta mbështesë arsimin kosovar"

English translation: Austria continue to support the Kosovar education


**16.07.2008**

Express - "Rektori i UP –së i priti studentët e laureuar në Vjenë"

English translation: Rector of the UP welcomed the awarded students in Vienna

Zëri - "Studentët kosovarë marrin shumë çmime në garën Rasti Sifdues Ndërkombëtar"

English translation: Kosovar students gain a lot of awards at the "International Case Challenge" com



Koha Ditore - "Rektori Hasani përgëzon studentët fitues në Austri"  
English translation: Rector Hasani welcomed the students, winners in Austria

Bota Sot - "Tri vendet e para rezervohen për studentët nga Kosova"  
English translation: The all three places taken from Kosovar students

Info Press - " Kthehen të fituar"  
English translation: Triumph return

**08.02.2008**

Nacionale - "Kosova Case Challenge"  
English translation: Kosova Case Challenge

Kosova Sot - "Rasti Sfidues, Ekonomiku më i interesuari"  
English translation: Case Challenge, Economics the most interested

Epoka e Re - "Rasti i studentëve..."  
English translation: Students' case...

Bota Sot - "Rasti Sfidues i Kosovës është gara më e madhe studentore në vend"  
English translation: Kosova Case Challenge is the biggest students' competition in the country

Lajm - "Dija peshohet në Vjenë"  
English translation: The knowledge is measured in Vienna

Zeri – „Rasti Sfidues i Kosoves, kete vit sjelli risi“

English translation: Kosova Case Challenge this year presents new concept

**07.02.2008**

Nacionale - "Programi "TEMPUS", 30 Projekte për UP – në"  
English translation: "TEMPUS" Program, 30 projects for the UP

Info Press - "UP përfiton 30 projekte"  
English translation: UP earns 30 projects

Kosova Live - "WUS Austria fton studentët për garën Rasti sfidues i Kosovës 2008"  
English translation: WUS Austria invites students for the Kosova Case Challenge 2008

Vazhdon mbështetja e shtetit austriak për arsimin e lartë në Kosovë

# Austria ndihmon UP-në me pesë projekte në tre vjetët e ardhshëm

Gjatë tre vjetëve shteti austriak do të ndihmojë arsimin e lartë publik kosovar në zhvillimin e tri programeve master, në zhvillimin e kurrikulit, prurjen e profesorëve të huaj, do të mbështesë Njësinë e zhvillimit akademik të UP-së, si dhe do të mundësojë që studentët kosovarë të sfidojnë njohuritë e tyre në garën ndërkombëtare "Rasti sfidues i Ballkanit"

REPORTAZHI

BESNIK KRASNIQI

PRISHTINË, 5 SHITATOR – Me pesë projekte, që kanë për qëllim mbështetjen për procesin reformues, Agjencia Austriake e Zhvillimit do ta mbështetë Universitetin e Prishtinës në tre vjetët e ardhshëm. Të pesë projektet, për implementimin e të cilave shteti austriak ka ndarë 833 mijë euro, janë lansuar të premten dhe janë mirëpritur nga menaxhmenti i Universitetit publik dhe përfaqësuesit e fakulteteve të këtij universiteti. Sipas asaj që u prezantua nga implementuesi i projekteve, WUS Austria, gjatë tri viteve shteti austriak do ta ndihmojë arsimin e lartë publik kosovar në zhvillimin e tri programeve master, në zhvillimin e kurrikulit, prurjen e profesorëve të huaj, do të mbështesë Njësinë e zhvillimit akademik të UP-së, si dhe do të mundësojë që studentët kosovarë të sfidojnë njohuritë e tyre në garën ndërkombëtare "Rasti sfidues i Ballkanit".


Udhëheqësi i Zyrës austriake për zhvillim, Andreas Fritz, ka theksuar se programi synon të sfidojë profesorët dhe studentët e UP-së me qasjet e avancuara në sistemin arsimor dhe në veçanti ballafaqimin me metodat e reja të mësimt.

Austria është financuesi më i madh i projekteve në arsimin kosovar, dhe sipas Fritzit një nga arsyeve më kryesore pse është zgjedhur Kosova për investime në arsim është fakti se projektet këtu janë implementuar me shumë sukses.

But Dedaj, koordinator i programeve të WUS-it për Kosovë, tekta ka shpjeguar formën e implementimit të projekteve, është shprehur se programet master janë krejtësisht të reja dhe të orientuara nga tregu i punës, dhe ka bërë të ditur se Rektorati ka vendosur që ato të implementohen në Fakultetin Juridik, në Fakultetin Filozofik dhe në Fakultetin e Mjekësisë.

Me projektin e dytë, zhvillimi i kurrikulit plus, Dedaj ka thënë se do të mbështeten profesorët që zbatojnë lëndë të reja mësimore, apo aplikojnë metodologji të re shkencore në lëndët ekzistuese. Profesorët do të mbështeten financiarisht për honorarët, për vizita studimore jashtë vendit dhe fakultetet do të kenë mundësi të blerjes së pajisjeve të nevojshme në vlerë deri në 10 mijë euro.

Projekti i tretë, i emëruar "Zhvillimi i trurit", synon të sjellë në Kosovë rreth 50 profesorë të lëmenjve të cak-



tuar për të mbajtur cikle ligjërimesh në UP. Ata do të kenë mundësi të vijë për hulumtime shkencore në Kosovë dhe po ashtu të jenë mentorë, për ta udhëhequr punën e ndonjë kandidati për tituj shkencorë pasuniversitarë.

Me projektin e katërt synohet punësimi i një zyrtari në Rektoratin e UP-së, që do të kujdeset për reformën dhe zhvillimin e kurrikulit. Projekti i pestë është "Rasti sfidues i Kosovës", që do të jetë gjysmëfinale e "Rastit sfidues të Ballkanit", i cili çdo vit organizohet në Austri. Me këtë synohet të nxiten studentët për t'u sfiduar me kolegët e tyre në këtë garë të njohurive. Për koordinatorin e programeve të WUS-it për Kosovë, But Dedaj, gjithë këto projekte do të thonë "mbështetje përmbytëse për procesin reformues", me të cilat synohet që arsimi i lartë kosovar të bëhet pjesë e arsimit të lartë evropian.

Shteti austriak vazhdon të mbështesë arsimin kosovar

# WUS-Austria lanson edhe pesë projekte për arsimin e lartë në Kosovë

Tri programe master që do të implementohen në Fakultetin Juridik, Filozofik dhe atë të Mjekësisë, projekti i zhvillimit të "kurrikulit plus", ai për zhvillimin e trurit, punësimi i një zyrtari në Rektorat që do të kujdeset për reformë dhe zhvillimin e kurrikulit në UP dhe "Rasti sfidues i Ballkanit", janë projektet në vlerë prej 833 mijë euro, të cilat u vlerësua se do të ofrojnë mbështetje përmbajtësore për procesin reformues në arsimin e lartë

## Besa Bytyçi


Shteti austriak do ta ndihmojë Kosovën, respektivisht Universitetin e Prishtinës (UP) edhe me pesë projekte në vlerë prej 833 mijë euro, të cilat do të ofrojnë mbështetje përmbajtësore për procesin reformues në arsimin e lartë në Kosovë.

Gjatë lansimit të këtyre projekte, i cili do të udhëhiqet nga WUS-Austria, ku morën pjesë edhe udhëhoqës të Universitetit dhe fakulteteve dhe financuesit e projektit, u tha se këto projekte janë një ndihmë e madhe për arsimin e lartë në vendin tonë dhe se këto mundësi duhet shfrytëzuar mirë.

But Dedaj, koordinator i programeve të WUS-it për Kosovë, tha se pesë projektet e planifikuara për UP-në janë të projektuara për tre vjetet e ardhshme dhe shpejtin ndihmën që Austria është duke dhënë përmes Agjencisë austriake të zhvillimit arsimor të lartë në Kosovë. "Kjo do të thotë mbështetje përmbajtësore për procesin reformues dhe sa më shpejt të bëhemi pjesë e arsimit të lartë evropian".

Në kuadër të këtyre pesë projekteve përshihet zhvillimi i tre master programeve të reja, për të cilat Rektorati ka vendosur që të implementohen në Fakultetin Juridik, Filozofik (në departamentin Shkencë Politike dhe Psikologji) dhe në atë të Mjekësisë.

"Programet master janë krejtësisht të reja dhe janë të orientuara nga tregu i punës", tha Dedaj, sipas të cilit kurrikulli për këto programe do të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me universitetet austriake, ndërsa ato do të kenë nga 2-5 module që do të kenë 3-5 lëndë me 120 ose 60 kredi varësisht nëse fakulteti dëshir



ron të zhvillojë program një apo dy-ëçar.

Projekti i dytë është projekti i zhvillimit të "kurrikulit plus", në kuadër të së cilit do të mbështeten profesorët që zbatojnë lëndët e reja mësimore, apo aplikojnë metodologji të re shkencore në lëndët ekzistuese.

Sipas Dedajt, profesorët do të mbështeten financiarisht për honorare, do të mbështeten për vizita studimore jashtë dhe fakultetet do të kenë mundësi të bërjes së pajisjeve të nevojshme në vlerë deri në 10 mijë euro.

Projekti i tretë është ai për "zhvillimin e trurit", i cili tani më është i njohur në Kosovë, ku 50 profesorë të llojeve të ndryshme do të vijnë dhe të mbajnë cilësi të ligjeratave në Universitetin e Prishtinës. Profesorët e huaj kanë mundësi të vijnë për hulumtime shkencore në Kosovë dhe po ashtu do të ketë mundësi të jenë mentorë për ta udhëhequr punën e ndonjë kandidatit.

Projekti i katërt përfshin punësimin e një zyrtari në Rektorat që do të kujdeset për reformë dhe zhvillimin e kurrikulit në UP, ndërsa programi i pestë është "Rasti sfidues i Ballkanit", respektivisht "Rasti Sfidues i Kosovës", projekt ky që tani ka një vit që është zbatuar në vendin tonë.

Dedaj tha se këto projekte, përveç mbështetjes financiare, ndihmojnë edhe në rrejtësimin, lidhjen me universitetet evropiane, meqenëse profesorët mund të shkojnë jashtë një kohëzgjatje prej një javë dhe përmes qëndrimit jashtë të arrijnë të mbledhin materiale të njohësive për të zhvilluar lëndën e re mësimore.

Ndërkaq, udhëhoqësi i Zyrës Austriake për Zhvillim (e cila edhe e financon projektin), Andreas Fritz, tha me këtë rast se programi synon të sfidojë profesorët dhe studentët e UP-së me qasjet e avancuara në sistemin arsimor dhe në veçanti ballafaqimin me metodat e reja të mësimin.

Austria është edhe financuesi më i madh i projekteve në arsimin kosovar dhe Fritz tha se një nga arsyet më kryesore pse është zgjedhur Kosova për investime në arsim është fakti se projektet këtu janë implementuar me shumë sukses. "Ne dëshirojmë që ta avancojmë sa më shumë arsimin kosovar që të jetë i krahasueshëm me arsimin në vendet më të zhvilluara", u shpreh ai.

Në anën tjetër, Luan Ahma, prorektor për çështje akademike në UP, falënderoi shtetin austriak për ndihmën që i ka dhënë dhe po i jep arsimin kosovar dhe tha se projektet e tilla duhet të shfrytëzohen sa më shumë që të jetë e mundur.

# Mbështetje për pesë projekte

PRISHTINË, 5 SHTATOR —

Universiteti i Prishtinës (UP) mori sot mbështetje nga shteti austriak për pesë projekte në vlerë prej 833 mijë euro, projekte këto që vlerësohen se do të ofrojnë mbështetje përmbajtjesore për procesin refor-

mues në arsimin e lartë në Kosovë. Kjo u bë e ditur me rastin e lansimit të projektit ËUS– Austria, në të cilën pjesëmarrës ishin dekanët e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës dhe financuesit e projekteve. Bud Dedaj, koordinator i

programeve të ËUS-Austria për Kosovë, tha se pesë projektet e planifikuara për Universitetin e Prishtinës janë të projektuara për tri vitet e ardhshme dhe shprehin ndihmën që Austria është duke dhënë përmes Agjencisë austriake

të zhvillimit për arsimin e lartë në Kosovë. Në kuadër të këtyre pesë projekteve përfshihet: zhvillimi i tre master programeve të reja në Fakultetin Juridik, një në Fakultetin Filozofik dhe në një në Fakultetin e Mjekësisë.



05.09.2008

## WUS-Austria financon 5 projekte në Universitetin e Prishtinës

13:34 ET Prishtinë (KosovaLive)



Universiteti i Prishtinës (UP) mori të premtën mbështetje nga shteti austriak për pesë projekte në vlerë prej 833 mijë euro, projekte këto që vlerësohen se do të ofrojnë mbështetje përmbajtjesore për procesin reformues në arsimin e lartë në Kosovë.

Kjo u bë e ditur me rastin e lansimit të projektit WUS– Austria, në të cilën pjesëmarrës ishin dekanët e fakulteteve të Universitetit të Prishtinës dhe financuesit e projekteve.

Bud Dedaj, koordinatori i programeve të WUS-Austria për Kosovë, tha se pesë projektet e planifikuara për Universitetin e Prishtinës janë të projektuara për tri vitet e ardhshme dhe shprehin ndihmën që Austria është duke dhënë përmes Agjencisë austriake të zhvillimit për arsimin e lartë në Kosovë.

“Fondi i përgjithshëm për këto pesë projekte është rreth 833 mijë euro. Kjo do të thotë mbështetje përmbajtjesore për procesin reformues dhe sa më shpejt të bëhemi pjesë e arsimit të lartë evropian”, tha Dedaj.

Në kuadër të këtyre pesë projekteve përfshihet: zhvillimi i tre master programeve të reja në Fakultetin Juridik, një në Fakultetin Filozofik dhe në një në Fakultetin e Mjekësisë.

Projekti i dytë është projekti i zhvillimit të “kurrikulit plus”, në kuadër të së cilës do të mbështeten profesorët që zbatojnë lëndët e reja mësimore, apo aplikojnë metodologji të re shkencore në lëndët ekzistuese.

Sipas Dedajt, profesorët do të mbështeten financiarisht për honorarët, mbështeten për vizita studimore jashtë dhe fakultetet do të kenë mundësi të blerjes së pajisjeve të nevojshme në vlerë deri në 10 mijë euro.

Projekti i tretë vlerësohet të jetë projekti “zhvillimit të trurit”, i cili tani më është i njohur në Kosovë, ku 50 profesorë të lëmenjve të caktuar do të vijnë dhe do të mbajnë cikël të ligjëratave në Universitetin e Prishtinës.

Profesorët e huaj kanë mundësi të vijnë për hulumtime shkencore në Kosovë dhe po ashtu do të ketë mundësi të jenë mentorë për ta udhëhequr punën e ndonjë kandidati.

Projekti i katër përfshin punësimin e një zyrtari në Rektorat që do të kujdeset për reformë dhe zhvillimin e kurrikulit në UP, ndërsa programi i pestë është “Balkan Case Challenge”, projekt që tani ka një vit që është zbatuar.

Dedaj tha se këto projektet përveç mbështetjes financiare, ndihmojnë edhe në rrjetëzimin, lidhjen me universitetet evropiane, meqenëse profesorët mund të shkojnë jashtë në kohëzgjatje prej një javë dhe përmes qëndrimit javor të arrijnë të mbledhin materiale të mjaftueshme për të zhvilluar lëndën e re mësimore.

/b.salihu/ <<<<

# Info Youth

Rubrikë për të rinj dhe adoleshentë

infoyouth@infopress-rh.com

Edhe një tjetër kontratë e rëndësishme për Universitetin e Prishtinës

## Austria i 'zgjat dorën' UP-së

♦ 833 mijë euro ndihmë nga shteti i Austrisë për Universitetin e Prishtinës  
Edhe 3 programe të reja master

Fitim Uka

PRISHTINË, 17 KORRIK

Universiteti i Prishtinës ka nënshkruar të enjten një kontratë me shtetin e Austrisë, me ç'rast do të përfitojë një shumë prej 833 mijë eurosh, të cilat do të investohen në 5 projekte multidimensionale të UP-së. Zbatimi i këtyre programeve do të bëhet nga ana e VUS-Austria.

### Ndihmë e jashtëzakonshme

Rektori i Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani, ka falënderuar shtetin austriak për ndihmën e dhënë, duke thënë se një ndihmë e tillë e vazhdueshme në arsimin e

Kurioziteti i ditës

## Përrjashtohen nga qyteti shkarravitësit

Drejtësia kanadeze ka urdhëruar një artist që pikuron me grafitë të qëndrojnë larg qytetit London, në Ontario, Kanada, përveç në rastet kur është i shoqëruar nga mamaja. Jonathan Chapman, 28-vjeçar, u arrestua se shkroi mbi një ndërtesë fjalët "Oscar". Këtë javë ai u arres-

tua me 14 akuza, pasi nëpër pallatet e qytetit u gjendën më shumë "Oscar" të tjerë. Drejtësia e paqes e dënoi me përjashtim nga qyteti. Ai mund të hyjë në qytet vetëm i shoqëruar nga mamaja. Chapman u ndalua të mbajë çdo lloj kanoçeje ngjyrosësh që përdoret për "artin" grafit.



# AUSTRIA NDIHMON UP-në ME 883 000 EURO

Shuma e dhënë nga Austria për UP-së prej 883 000 euro, është dedikuar në projekte zhvillimore dhe do të zbatohet në një periudhë pre tre vjetësh.

Prishtinë, 17 korrik

Nënskruhet kontrata ndërmjet Austrisë dhe UP-së lidhur me mbështetjen e programeve nga VUS-Austria dhënë UP-së për periudhën (2008-2011). Në këtë rast është vlerësuar se VUS austriak edhe në vitet tjera paraprake përmes formave dhe programeve të ndryshme ka ndihmuar arsimin e lartë në Kosovë. Duke vlerësuar ndihmën e Austrisë për UP-në, rektori Enver Hasani ka falënderuar ambasadorin e Austrisë në Kosovë Gernot Pfander, i cili ka çmuar si të dobishëm edhe nënshtetimin e këtij memorandum bashkëpunimi. Ky memorandum ka tërhequr nga VUS Austria donacionin në shumën prej 883 000 euro. "Këto projekte ndihmojnë edhe natyrën e studimeve master në Universitetin e Prishtinës, atyre që studiojnë jashtë vendit si dhe kurseve që ndikojnë në njësitet e zhvillimeve akademike. Mirëpo, paraprakisht Austria ka ndihmuar AL në Kosovë në forma dhe mënyra të ndryshme, gjithnjë duke u përqendruar në avancimin e sistemit universitar në UP, vlerësoi rektori Hasani. Ai theksoi se duke ndikuar në ngritjen e nivelit akademik të studentëve tanë, pak ditë më parë studentët e UP-së janë kthyer në Kosovë me suksese të mëdha në garat e dijës që është mbajtur në Vjenë të Austrisë. Në këtë kontekst

janë ngritur edhe nivele të bashkëpunimit në mes të UP-së dhe universiteteve të tjera austriake duke ndikuar në arritjen e standardeve evropiane në AL. Ndërkaq ambasadori i Austrisë në Kosovë, Gernot Pfander, ka çmuar lart frymën e vazhdueshme të bashkëpunimit në mes të UP-së dhe universiteteve austriake duke u shprehur se projekte dhe donacione të tilla do të dhurohen edhe në të ardhmen në UP. "Kontaktet tona do të jenë të vazhdueshme me UP-në dhe ndihma jonë do të përqendrohet në ato projekte ku AL-ja dhe UP-ja kanë më shumë nevojë për ndihmën tonë", vlerësoi ambasadori, Pfander. Ndërkaq, përfaqësuesi i VUS, Austrisë, But Jaku, vlerësoi se ky vend përmes donacioneve të ndryshme ka dhënë dhe vazhdon të dëshmojë ndihmë të vazhdueshme për AL, dhe Universitetin e Prishtinës. "Kjo natyrë e bashkëpunimit dëshmon se forma e re e ndërkomunikimit në mes të institucioneve të larta të Kosovës dhe atyre nga Austria. Këto projekte do të zbatohen në një periudhë pre tri viteve. Kjo asistencë e radhës vjen në kuadër të vazhdimësisë që Austria po i bën UP-së dhe Kosovës në përgjithësi", vlerësoi, z. Jaku. Ai theksoi se VUS Austria është zbatues i programeve që ndihmojnë stafin profesional. Kjo dëshmon se AL në Kosovë dhe ato simotra në Austri po thellojnë edhe më tej frymën e bashkëpunimit në shkallë akademike. Kjo fazë e re e bashkëpunimit apo binjakëzimit të UP-së dhe atyre të Austrisë kalojnë natyrën e bashkëpunimit bilateral, ngase në këtë kontekst përfshihet edhe forma tjetër e binjakëzimit në mes të natyrave të AL-së në interes të ndërsjellët. "Faza e parë e këtij bashkëpunimi

ka qenë 1998-2002, mirëpo shteti i Austrisë ka ndihmuar konkretizimin të projekteve bazë të UP-së. Pas kësaj faze është ndihmuar në mbështetjen e profesorëve në avancimin e kurikulave, programeve mësimore në UP, ku janë përfshirë edhe bashkëpunimi në shkallën e mesimdhënies. Në këtë fazë bashkëpunimi janë arritur një sërë avancimesh të natyrës profesionale dhe puja e vlerave evropiane edhe në AL të Kosovës", vlerësoi But Jaku. Ai nënvizoi faktin se faza e fundit mbështetet në komponentët e bashkëpunimit në mes të UP-së dhe universiteteve nga Austria. E gjithë kjo nënkupton edhe përgatitjen e master programeve të cilat kanë për qëllim përgatitjen e kuadrove për tregun e punës. Krahas kësaj përfshihet edhe zhvillimi i trurit. Në këtë kontekst nënkuptohet për të gjithë stafin akademik mesimdhënës, ku profesorët të ndryshëm që kanë fituar grante të ndryshme shkencor në botë të vijnë dhe të mbajnë cikle ligjërimesh në UP. Kjo përfshin edhe profesorët nga Austria. Në këtë kontekst mesimdhënësit nga UP-ja të ligjërojnë apo demonstrojnë vlerat e tyre në ndonjërin nga universitetet evropiane. E gjithë kjo ka për qëllim arritjen e standardeve nivelizuese të AL-së me atë evropian dhe më gjerë. Rezultati i jashtëzakonshëm i studentëve tanë në Vjenë është vetëm një kënd i këtij angazhimi, i cili edhe në të ardhmen do të ndihmojë arritjen e vlerave uni-ke në UP. Ndërkaq, Andreas Fritz AA për Zhvillim vlerësoi se Austria do të ndihmojë edhe në të ardhmen Universitetin e Prishtinës me programe që avancojnë sistemin edukativ arsimor në Kosovë.

Ramiz BOJAJ



## Universiteti i Prishtinës nënshkruan marrëveshje mirëkuptimi me shtetin austriak

# Austria i jep edhe një ndihmë arsimit të lartë në Kosovë

"Austria gjithmonë është fokusuar në kooperimin me Kosovën në fushën e çështjeve të arsimit të lartë, sepse ne gjithmonë kemi besuar te njerëzit e rinj dhe dinamikë në Kosovë dhe kemi dëshiruar të inkurajojmë potencialet e tyre", tha ambasadori i Austrisë në Kosovë, Gernot Fandler

### Besa Bytyçi

Me qëllim të mbështetjes dhe reformimit të arsimit të lartë në Kosovë, rektori i Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani, dhe përfaqësues të shtetit austriak, kanë nënshkruar dje një memorandum mirëkuptimi, sipas të cilit Austria do të mbështesë universitetin publik me një projekt në vlerë 833 mijë euro, në periudhën kohore 2008-2011, përmes zbatimit të plan programeve nga ana e WUS-Austria.

Rektori Hasani tha se projekti në fjalë është në mbështetje të reformave që tashmë janë në zhvillim e sipër në UP. Ndërsa, ky projekt, sipas tij, dëshmon edhe një herë ndihmën që po i jep shteti i Austrisë arsimit të lartë në Kosovë, e veçmas UP-së. "Kemi nënshkruar kontratën për 5 projekte, të cilat janë pjesë e projektit multidimensional që është në vijim e sipër, e që lidhet me zhvillimin e studimeve master në UP, që kanë të bëjnë me trajnimin e të rinjve që studiojnë jashtë, zhvillimin e kurseve, projekti reforma e universitetit dhe zhvillimin e njësive akademike që lidhet me reformën dhe 'Kosova case challenge', të cilin e nënshkruam para disa ditësh", ka numëruar ai.

Ndërsa, ambasadori i shtetit të Austrisë në Kosovë, Gernot Fandler, është shprehur krenar për arritjen e kësaj kontrate dhe ka premtuar se bashkëpunimi do të vazhdojë edhe në të ardhmen. "Ky është një shembull i shkëlqyeshëm se si mund të bëhet bashkëpunimi në fushën e arsimit. Austria gjithmonë është fokusuar në kooperim-



Austria do të mbështesë Universitetin e Prishtinës me një projekt në vlerë 833 mijë euro, në periudhën kohore 2008-2011, përmes zbatimit të plan programeve nga ana e WUS-Austria

in me Kosovën në fushën e çështjeve të arsimit të lartë, sepse ne gjithmonë kemi besuar te njerëzit e rinj dhe dinamikë në Kosovë dhe ne kemi dëshiruar të inkurajojmë potencialet e tyre", ka thënë ai, duke shtuar se vendi i tij do të vazhdojë kooperimin me Kosovën që ndërliiden me shumë çështje.

Edhe Andreas Fric, drejtor i Korporatës Zhvillimore Austriake në Kosovë, ka përgëzuar WUS-in dhe UP-në për projektin tradicional, i cili është vazhdimësi e programit të mëhershëm. Ai tha se projekti për mbështetje në arsim është një sektor i rëndësishëm dhe ky projekt mund të jetë një rrëfim i suksesshëm me një partner të fuqishëm dhe kompetent si WUS-Austria dhe benificionet që do të ketë prej tij Universiteti i Prishtinës dhe studentët.

Fric ka siguruar se bashkëpunimi

mi në fushën e arsimit të lartë do të vazhdojë edhe pas tri vjetësh, kur të ketë përfunduar ky projekt

Në anën tjetër, But Dedaj, përfaqësues i WUS-Austria në Kosovë, theksoi se kjo fazë e re që po fillon tash me nënshkrimin e këtij memorandum, mund të quhet fazë e binjakëzimit apo bashkëpunimit më të thellë në mes të UP-së dhe universiteteve austriake, sepse, siç tha ai, njëra nga komponentët në kuadër të programeve master përfshin edhe mundësinë e binjakëzimit të universitetit publik të Kosovës me ndonjë universitet, respektivisht fakultet nga Austria.

Ai tregoi se gjithsej do të zhvillohen pesë programe në Universitetin e Prishtinës, të cilat do të jenë më tepër të orientuara nga përgatitja e kuadrove për tregun e punës.

Universiteti i Prishtinës nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Austrinë

# Mbi 800 mijë euro për Universitetin e Prishtinës

**Pesë projektet që përfshin kontrata janë: zhvillimi i 3 master programeve të reja, programi i zhvillimit të trurit, zhvillimi i lëndëve mësimore, plus punësimi i një zyrtari i cili do të kujdeset për planprogramin mësimor në UP dhe në Kosova Case Challenge, ose rasti sfidues i Kosovës, i cili zhvillohet si gjysmëfinale në Kosovë, ndërsa fituesit shkojnë në finale në Vjenë**

KOHA  
Ditore

NEXHAT TOVËRLANI

PRISHTINË, 17 KORRIK - Rektori i Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani, dhe përfaqësues të Austrisë kanë nënshkruar të enjten një memorandum bashkëpunimi dhe një kontratë për të ndihmuar kryesisht studentët kosovarë. Kontrata e nënshkruar kap shumën 883 mijë e 300 euro dhe përfshin pesë projekte. Projektet e përfshira në kontratë janë: zhvillimi i 3 master programeve të reja, programi i zhvillimit të trurit, zhvillimi i lëndëve mësimore, plus punësimi i një zyrtari i cili do të kujdeset për planprogramin mësimor në UP dhe Kosova Case Challenge, ose rasti sfidues i Kosovës i cili zhvillohet si gjysmëfinale në Kosovë, ndërsa fituesit shkojnë në finale në Vjenë.

Rektori i UP-së, Enver Hasani, me rastin e nënshkrimit të memorandumit e ka quajtur projektin si multidimensional. "Ne sot në bashkëpunim me shtetin austriak do të nënshkruajmë memorandumin e bashkëpunimit dhe kontratën për pesë projektet që do të përfitojnë kryesisht studentët. Kjo është një mundësi e mirë për ta dhe besoj se ndihmat do të vazhdojnë edhe në të ardhmen", është shprehur rektori Hasani.

Ambasadori i Austrisë në Kosovë, Gernot Plandler, ka thënë se është një rast i mirë për të që mund të nënshkruajë këtë kontratë.

"Kjo nuk është diçka që do të përfundojë, por do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ka shumë përfaqësues të elitës politike dhe ekonomike që kanë dalë nga programe të sponsorizuara nga WUS - Austria, dhe mendoj që ky është një shembull i mirë se si një korporatë në fushën e edukimit mund të punojë", ka thënë Plandler.

Ambasadori austriak ka thënë se shteti i tij gjithmonë ka qenë i lidhur me sistemin e edukimit të lartë në Kosovë. Sipas tij, kjo është bërë sepse kanë besuar në potencialin e rinisë dinamike në Kosovë dhe ka qenë dëshira për të inkurajuar dhe forcuar atë rini.

Përfaqësuesi i Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADC), Andreas Fritz, ka thënë se kjo është vetëm një vazhdimësi e një programi që kanë filluar në vitin 1998.

"Edukimi është sektori kryesor të cilin po e mbështesim. Me këtë projekt mund të vazhdojmë mbështetjen tonë të fuqishme me partnerin tonë të fortë WUS Austria. Kjo do të garantojë një korporatë që zgjat deri në 2011 dhe jam i sigurt që do të



vazhdojë edhe më tej", thotë Fritz.

But Dedaj, përfaqësues i WUS Austria për Kosovë, thotë se këto fonde që kapin shifrën 833 mijë e 300 euro do të zbatohen në Universitetin e Prishtinës në tre vjetet e ardhshëm.

"Kjo është bërë në kuadër që shteti i Austrisë është duke e ndihmuar arsimin e lartë në Kosovë, respektivisht Universitetin e Prishtinës. Kjo dëshmon se bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë të Kosovës dhe Austrisë po thellohet. Do të ketë mundësi të binjakëzimit të fakulteteve të Austrisë me fakultete të UP-së", ka theksuar Dedaj. Ai ka shpjeguar edhe programet e paraqitura në marrëveshje. "Në programin e parë shikohet mundësia e binjakëzimit të fakulteteve të UP-së dhe atyre të Austrisë. Programi i dytë parasheh që profesorë nga Austria që janë me origjinë shqiptare, por edhe austriakë të mbajnë ligjërata në Universitetin e Prishtinës. Programi i tretë ka për qëllim që profesorët e UP-së të udhëtojnë jashtë dhe në bashkëpunim me kolegët e tyre të huajë të zhvillojnë lëndë mësimore dhe t'i sjellin ato në Kosovë. Programi i katërt ka të bëjë me punësimin e një zyrtari i cili do të kujdeset për planprogramin mësimor në UP, i cili në fillim paguhet nga fondi i Austrisë, vitin e dytë 80 %, vitin e tretë 50-50 me UP-në dhe vitin e katërt të kalojë si staf lokal. Programi i pestë parasheh që studentët të garojnë në katër raste të ndryshme, në rastin e biznesit, teknologjisë informative, stimulimi i funksionimit të Këshillit të Evropës dhe stimulimi i rastit të gjyqit", ka thënë Dedaj.

Prej vitit 1998 Austria kishte ndihmuar Universitetin e Kosovës edhe me materiale dhe pajisje që ka pasur nevojë UP-ja. Ndërsa, prej vitit 2000 kanë filluar edhe me ndihma profesionale.

E PREMTE, 18 KORRIK 2008

## AUSTRIA I JEP UP-së MBI 800 MUJË EURO

**R**ektori Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani, nënshkroi marrëveshjen për ndihmë më përfaqësues të shtetit Austriak dhe të Agjencisë Austriake për zhvillim. Qeveria e Republikës së Austrisë ndihmoi Universitetin e Prishtinës me një donacion prej rreth 833.300 eurosh, që do të jetë ndihmë për tri vitet e ardhshëm. I pranishëm në ceremoninë e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, pos përfaqësuesit të Agjencisë Austriake për zhvillim, Andreas Fritz, ishte edhe ambasadori Austriak në Prishtinë, Gernot Pflander.

Rektori i UP-së, Enver Hasani, tha se memorandumit ka të bëjë me pesë nga projektet si: Hapja e programeve të reja të masterit në universitet, Projekti i kthimit të rinjve tanë që studiojnë nëpër botën e jashtme dhe angazhimi i tyre në ciklin e ligjëratave në UP, reforma e universitetit dhe zhvillimi i njësive akademike, dhe 'Kosova Case Challenge', ku, sipas rektorit, në këtë projekt studentët e Universitetit të Prishtinës u treguan shumë të suksesshëm në kuizet e diturisë që ishin organizuar më datën 10-11 maj 2008 në Vjenë të Austrisë. Ndërkaq, ambasadori i Austrisë në Prishtinë, Gernot Pflander, tha se investimi në arsimimin e lartë në Kosovë dhe rinia e mrekullueshme këtu është një arsye më tepër për të pasur bashkëpunim të shkëlqyer në mes nesh.

Sejdi M.GASHI

# Austria vazhdon ta mbështesë arsimin kosovar

Prishtinë, 17 korrik - Universiteti i Prishtinës (UP) do ta ketë përkrahjen e shtetif të Austrisë në implementimin e programeve për periudhën kohore 2008-2011. Ky memorandum është nënshkruar të enjten nga rektori i UP-së, Enver Hasani, dhe nga ambasadori i Austrisë në Kosovë, Gernot Fandler. Rektori Hasani tha se nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit dhe i kontratës për pesë projekte janë pjesë e Projektit multidimensional, që ka të bëjë me zhvillimin e studimeve master në universitet. Ndërkaq, ambasadori Fandler tha se Austria gjithmonë ka qenë fuqimisht e fokusuar në kooper-

imin me Kosovën në fushën e arsimit të lartë. "Ne dëshirojmë të inkurajojmë potencialin e popullatës së re të Kosovës. Bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve në fushën e arsimit do të vazhdojë edhe në të ardhmen", tha ai. But Dedaj, përfaqësues i Wus Austria, tha se për pesë programe në UP do të ndahen fondet në vlerë 833.300 euro. "Gjatë tre vjetëve të ardhshëm, këto programe do të jenë të orientuara për përgatitjen e kadrove për tregun e punës". Nënshkrimi i Memorandumit është vlerësuar si fazë e bashkëpunimit më të thellë ndërmjet UP-së dhe universiteteve austriake. (a. k.)

Lajm; 18.07.2008 pg. 8

# Rektori i UP-së i priti studentët e laureuar në Vjenë

Prishtinë, 15 korrik - Rektori i Universitetit të Prishtinës (UP), Enver Hasani, të martën e priti grupin e studentëve që kanë marrë pjesë dhe njëkohësisht kanë arritur rezultate të larta në garën "Balkan Case Challenge", që është mbajtur javën e kaluar në Vjenë. Ai i inkurajoi studentët të vazhdojnë më tutje në projekte të njëjta, që përvojën e tyre ta ndajnë me kolegët e tyre. Përfaqësuesi i Wus-Austria në Kosovë, But Dedaj, tha se gara në Vjenë ka qenë vazhdim i gjysmëfinaleve së mbajtur në Kosovë në maj. Edhe studentët pjesëmarrës garën e

kanë vlerësuar si një përvojë të mirë për të ardhmen. Njëra nga fitueset e garës "Balkan Case Challenge" në Vjenë, Ryva Limani, tha se shpërblimi i saj ka qenë "Më diplomatikja" dhe me marrjen e çmimit ka qenë e entuziazmuar.

Kjo garë i ka tubuar studentët që kanë fituar në 12 gjysmëfinale, që janë mbajtur paraprakisht para afro dy muajve, si në Moldavi, Bullgari, Romani, Serbi, Maqedoni, Kosovë, Shqipëri, Bosnjë e Hercegovinë, Kroaci, Mal i Zi, Slloveni dhe Austri. Në këtë garë kanë qenë gjithsej 142

studentë konkurrentë. Gara : nizuara nga Wus-Austria, është  
"Balkan Case Challenge", orga : mbajtur nga 6 deri më 11 korrik.



Rektori i UP-së priti një grup studentësh që kanë garuar në Vjenë

## Studentët kosovarë marrin shumë çmime në garën "Rasti sfidues ndërkombëtar"

"Keni mbështetjen e rezervë të UP-së dhe shpresojmë që të vazhdoni edhe studimet në master dhe doktoratë dhe të bëheni shumë shpejt pjesë e stafit akademik të UP-së", u tha studentëve rektori Enver Hasani



"Keni mbështetjen e rezervë të UP-së dhe shpresojmë që të vazhdoni edhe studimet në master dhe doktoratë dhe të bëheni shumë shpejt pjesë e stafit akademik të UP-së", u tha studentëve rektori Hasani

Rektori i Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani, ka pritur një grup studentësh që kanë marrë pjesë dhe njëherësh kanë arritur rezultate shumë të larta në garën "Rasti sfidues ndërkombëtar" në Vjenë të Austrisë, nga data 6 deri më 11 korrik, organizuar nga Vus-Austria.

Studentët nga Kosova i kanë hyrë garës që është zhvilluar javën e kaluar, e që ka qenë vazhdim i gjysmëfinales që është mbajtur në Kosovë në muajin maj. Ata kanë marrë shumë çmime në finalen e madhe dhe sipas organizatorëve, Kosova është vendi që ka rrëmbyer më së shumti çmime, nga 12 shtetet pjesëmarrëse në garë.

Rektori Enver Hasani inkurajoi studentët që të vazhdojnë të punojnë me projekte të tilla.

"Keni mbështetjen e rezervë të UP-së dhe shpresojmë që të vazhdoni edhe studimet në master dhe doktoratë dhe të bëheni shumë shpejt pjesë e stafit akademik të UP-së", u tha ai studentëve.

Ndërkaq, përfaqësuesi i Vus-Austria në Kosovë, But Dedaj, theksoi se kjo është një dëshmi e jashtëzakonshme se niveli i studentëve tanë është mjaft i lartë dhe

isht do të jeni shtyllat kryesore të reformimit të sistemit të arsimit të lartë në të ardhmen në Kosovë".

Një sukses i madh është arritur kur tre studentë nga Kosova, që kanë arritur në finale, kanë marrë tri çmimet e para në fushën e biznesit. Studentja Hyra Limani, e cila ka konkurruar në këtë garë me projektin "Modeli i Këshillit të Evropës", është shpërblyer me çmimin për diplomaci. "Ka qenë Modeli i Këshillit të Evropës, kam mbledhur kryetarët e vendeve. Shpërblimi im ka qenë në fushën diplomatike, si çmim i dytë. Kam qenë shumë e shokuar, mendoj që ka pasur shumë garues të mirë, nuk e di cili ka qenë kriteri që më kanë zgjedhur. Në garën e biznesit kanë qenë tri vendet e para...".

Në këtë garë kanë marrë pjesë 142 studentë nga vende të Evropës, ku më shumë fitues ka pasur nga Kosova. Fituesit, si shpërblim kanë marrë bursa për studime dhe shumë mundësi për trajnime dhe praktika jashtë vendit. Studentët thanë se edhe shpërblimet e tilla janë përshtatur me lëmin për të cilën ata studiojnë në UP dhe se ato janë të mirëseardhura për të filluar karrierën e tyre.

Kjo garë ka filluar të bëhet traditë edhe në Kosovë, ku po organizohet

"ZËRI" 16.07.2008

Rektori i UP-së pret pjesëmarrësit e garës ndërkombëtare në Vjenë

# Rektori Hasani përgëzon studentët fitues në Austri

KOHA  
DITORE

SHKAMB QAVDARBASHA

PRISHTINË, 15 QERSHOR – Studentët të cilët kanë treguar arritje të mëdha në një garë ndërkombëtare në aplikimin në praktikë të njohurive në Austri janë pritur të hënën nga Rektori i Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani. Rektori shprehu mirënjohjen e tij ndaj këtyre studentëve, si dhe u zotua se UP-ja do ta mbështesë organizatën WUS Austria, e cila kishte mundësuar pjesëmarrjen në garë të studentëve kosovarë.

Këta studentë kanë dëshmuar aftësitë e tyre në fushat e biznesit, drejtësisë, diplomacisë etj., duke shënuar suksesin më të madh nga 12 vendet pjesëmarrëse në këtë garë.

But Dedaj, drejtori ekzekutiv i WUS-Austria në Kosovë, duke theksuar se Kosova ka marrë më së shumti çmime në këtë garë, ka thënë se vendi i dytë në këtë garë “nuk i afrohet as gjysmës së çmimeve që i kemi fituar ne”.

Sipas Dedajt, në këtë konkurs kanë marrë pjesë 142 studentë finalistë nga 12 shtete.

Ardi Shita ka dalë fitues i çmimit për garën në drejtësi. Shita dhe grupi i tij kanë pasur rastin të veprojnë si avokatë para një simulimi të Gjyqit Ndërkombëtar të Drejtësisë, duke përfaqësuar një shtet i cili gjoja ishte vërshtuar nga uji si pasojë e nxehjes globale.

“Ka qenë një sfidë, sepse nuk është një çështje që është e rregulluar mirë me të drejtën ndërkombëtare, dhe na është dashur të improvizojmë e të hulumtojmë shumë”, ka thënë Shita, duke folur për rastin e improvizuar. Shita ka marrë si çmim një muaj studime kërkimore në Universitetin e Gratzit.

Lura Limani ka marrë pjesë në një model të Këshillit



të Evropës, duke përfaqësuar Letoninë. Duke e vlerësuar si përvojë të madhe përfaqësimin e një shteti të vogël, Limani ka mësuar se “nuk është me rëndësi masa, po si i prezanton faktet”. Ajo ka marrë çmimin për diplomatin më të mirë, dhe me të një trajnim mbi studimet demokratike në Austri.

Ndërsa në garën e biznesit të tri grupet më të mira, kanë pasur brenda tyre studentë nga Kosova.

Gara është sponsorizuar nga Grupi i Sigurimit të Vjenës. Albulena Xhelili, fituese e çmimit të parë prej 1.000 eurosh, ka thënë se “ka qenë një eksperiencë e jashtëzakonshme, vetë sfida ka qenë eksperiencë”. Ndërsa Baton Mati, marrësi i çmimit të dytë, në punimin e tezës së magistraturës me Grupin e Sigurimit të Vjenës, ka përshkruar pjesëmarrjen si “kënaqësi e posaçme”.

“Ka qenë kënaqësi e posaçme që kemi qenë pjesë e përfaqësisë të Kosovës”, ka thënë ai.

I gjithë ky sukses, sipas drejtorit të WUS-Austria, Dedajt, është “një dëshmi se niveli i studentëve tanë është shumë i mirë, mos të them që është më i mirë se në vendet e rajonit”.

KOHA DITORE ; 15.07.2008

SUKSESET E STUDENTËVE TANË NË VJENË

## TRI VENDET E PARA REZERVOHEN PËR STUDENTËT NGA KOSOVA

Në garën e madhe në Vjenë ku pjesëmarrës ishin 12 shtete nga rajoni dhe më gjerë, studentët nga Republika e Kosovës (UP), kanë arritur që të kurorëzohet me tri vendet e para, duke grumbulluar numrin më të madh të shpërblimeve.

*Prishtinë, 15 korrik*

Rektori i UP-së, Enver Hasani, priti një grup studentësh që kanë marrë pjesë në garën Balkan Case Challenge që është mbajtur në Vjenë. Duke çmuar angazhimin e studentëve në këtë rang garash ku pjesëmarrës ishin studentë nga rajoni dhe më gjerë, rektori Hasani, vlerësoi se fituesit e titullarëve të këtyre garave do të thotë demonstrim i cilësisë së përgjithshme të shkollës universitare në Arsimin e Lartë të Kosovës. "Dua të ju përgëzoj për sukseset që keni arritur në këtë rang garash duke shprehur përkushtimin tonë duke ju inkurajuar për punë të mëtutjeshme. Universiteti i Prishtinës në mënyrë të vazhdueshme do të përcjellë sukseset tuaja. Po ashtu dua të falënderoj edhe shtetin e Austrisë për ndihmën dhe angazhimin e saj në organizimin e një evenimenti të tillë, i cili nga afër pasqyron të arriturat e përgjithshme të universiteteve, veçanërisht vendeve pjesëmarrëse", vlerësoi rektori Hasani. Ai theksoi se vazhdimi i garës së diturisë për ju do të vazhdojë edhe me studimet tjera të shkollës master dhe të doktoratës, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të avancohet arsimi i lartë në Kosovë. Nderkaq përfaqësuesi i Vus Austria, prof. But Dedaj theksoi se Gara Ballkanike e mbajtur javën e kaluar në Vjenë ishte vazhdimësi e garës gjysmëfinale të mbajtur në

Kosovë në maj të këtij viti. Ai theksoi se kjo është dëshmi i nivelit të studentëve tanë, i cili është i arritshëm me universitete tjera në rajon dhe më gjerë. "Kjo është dëshmi se Kosova ka faktor zhvillimor dhe shpresojmë kjo kategori studentësh do të jenë shtylla kryesore e reformave të përgjithshme arsimore në Kosovë. Në këtë kontekst vizioni ynë është ngritur mbi parimet bazë të vlerave të përgjithshme", vlerësoi z. Dedaj. Falënderimi kryesor shkon për Austrinë vend ky i cili ka ndihmuar demonstrimin e një gare të tillë ndërkombëtare, ku në të njëjtën kohë janë pasqyruar edhe arritjet e shkollës studentore në Republikën e Kosovës. Në këtë garë kanë marrë pjesë edhe Maqedonia, Bullgaria, Kroacia, Shqipëria, Sllovenia etj. UP-ja edhe në këtë rast ka shprehur vetëm një kënd të punës që po zhvillohet aktualisht në arsimin e lartë të Kosovës, me theks në Universitetin Publik. Në këtë kontekst studentja përfituese në njërin nga shpërblimet në këtë garë, Albulena Xheli, vlerësoi se falë ndihmës së vazhdueshme të stafit mësimdhënës dhe të tjerëve, kemi arritur që të plasojmë në vendet më të mira. Finales së madhe në Vjenë i kanë paraprirë edhe vendet nga 12 shtete të rajonit, duke përfshirë edhe vendin tonë. 42 studentë pjesëmarrës kanë dëshmuar cilësi të jashtëzakonshme në lëmit përkatëse, përderisa privilegjet dhe bursat e fituara do të përdoren për avancimin profesional të tyre. Në këtë kontekst është vlerësuar se cilësia në AL të Republikës së Kosovës është mjaft e lartë dhe e vlerësuar edhe në këtë rast. Në garën e madhe në Vjenë ku pjesëmarrës ishin 12 shtete nga rajoni dhe më gjerë, studentët nga Republika e Kosovës, (UP), kanë arritur që të kurorëzohet me tri vendet e para, duke grumbulluar numrin më të madh të shpërblimeve

*Ramiz Bojaj*



Triumfojnë studentët nga Kosova në garën "Rasti sfidues ndërkombëtar"

# Kthehen të fituar

◆ Suksesi më i madh është shënuar nga tre studentë nga Kosova, që kanë arritur në finale dhe kanë marrë tri çmimet e para në fushën e biznesit

**Fitim Uka**

PRISHTINË, 15 KORRIK

**R**asti sfidues ndërkombëtar", është gara e organizuar në Vjenë të Austrisë, ku studentët nga Kosova kanë shënuar rezultate të jashtëzakonshme. Së këndejmi, nga 12 vendet pjesëmarrëse në këtë garë, Kosova ka dalë të jetë shteti me më së shumti çmime, sikurse edhe fitues. Rektori i Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani, ka pritur të martën grupin e studentëve që kanë marrë pjesë në këtë garë dhe u ka premtuar atyre përkrahje të vazhdueshme.

## Niveli i jashtëzakonshëm

"Keni mbështetje të parezervë të UP-së dhe shpresojmë që të vazhdoni edhe studimet në master dhe doktoratë, dhe të bëheni shumë shpejt pjesë e stafit akademik të UP-së", u ka thënë studentëve rektori Hasani.

Ndryshe, për përfaqësuesin e Vus Austrias në Kosovë, But Dedaj, kjo nuk është asgjë më shumë se një dëshmi se niveli i studentëve tanë është mjaft i lartë dhe se tregon që Kosova ka potencial zhvillimor. Sipas tij, këto çmime tregojnë se Ko-

sova ka potencial zhvillimor dhe mund të krenohet edhe për faktorin human.

"Shpresojmë që ju do të jeni ata të cilët do ta përshpejtoni zhvillimin ekonomik të Kosovës, e natyrisht do të jeni shtyllat kryesore të reformimit të sistemit të arsimit të lartë në të ardhmen në Kosovë", u ka thënë ai më tej studentëve.

## Kosova, bindshëm më e mira


Në këtë garë kanë marrë pjesë 142 studentë nga vende të Evropës, ku më shumë fitues ka pasur nga Kosova. Fituesit, si shpërblim kanë marrë bursa për

studime dhe shumë mundësi për trajnime dhe praktika jashtë vendit. Studentët thanë se edhe shpërblimet e tilla janë përshtatur me lëmin për të cilin ata studiojnë në UP dhe se ato janë të mirëseardhura për të filluar karrierën e tyre.

Suksesi më i madh është shënuar nga tre studentë nga Kosova, që kanë arritur në finale dhe kanë marrë tri çmimet e para në fushën e biznesit.

Studentja Hyra Limani, e cila ka konkurruar në këtë garë me projektin "Stimulimi i Këshillit Evropian", është shpërblyer me çmimin për diplomaci. "Ka qenë Stimulimi i Këshillit Evro-

pian, kam mbledhur kryetarët e vendeve. Shpërblimi im ka qenë në fushën diplomatike, si çmim i dytë. Kam qenë shumë e shokuar, mendoj që ka pasur shumë garues të mirë, nuk e di cili ka qenë kriteri që më kanë zgjedhur", ka thënë ajo akoma e emocionuar.



Leonora Shala


Prishtinë, 7 Shturt

WUS Austria, në një konferencë për shtyp, prezantoi projektin "Kosova Case Challenge" apo "Rasti Sfidues i Kosovës". Gara studentore është e bazuar në Metodën e Rastit Studimor që zhvillohet në katër raste: Rasti biznesor, ku përfaqësohen studentët e të gjitha fushave të ekonomikut;

Teknologjia informative dhe komunikuese për studentët e shkencave teknike; Modeli i këshillit të Evropës për studentët e shkencave politike, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, sociologji dhe fusha tjera të ngjashme dhe Simulimi i gjyqit për studentët e juridikut. Këtë vit do të jetë në 11 vende të Evropës Juglindore dhe në këtë rast edhe "Rasti Sfidues i Kosovës", që përfaqëson gjysmë finalen për "Ballkan Case Challenge", tha Drejtori i WUS Austria, But Dedaj, dhe shtoi se "Kosova Case Challenge 2008" është organizuar këtu tri vitet e fundit dhe shtoi se "KCC 2008" do të organizohet në një dimension pak më ndryshe se herëve të kaluara. Sipas tij, "Rasti Sfidues i Kosovës" synon në hapjen e mundësive dhe perspektivave të reja për studentët e shkëlqyer të Edukimit të Lartë të Kosovës, duke i forcuar lidhjet në mes të edukimit të lartë dhe punësimit si dhe me ofrimin e shanseve konkrete për punë

# "KOSOVA CASE CHALLENGE"

"Rasti Sfidues i Kosovës" synon hapjen e mundësive dhe perspektivave të reja për studentët e shkëlqyer të Edukimit të Lartë të Kosovës, duke i forcuar lidhjet në mes të edukimit të lartë dhe punësimit si dhe me ofrimin e shanseve konkrete për punë



### Projekti

WUS Austria implementon programe mbështetëse në Evropën Juglindore që nga viti 1994 duke u fokusuar në universitete dhe komunitet akademike. Kurse në Kosovë operon që nga viti 1998.

Evropa Juglindore dhe Austria", potencoi Dedaj. Me këtë rast "Kosova Case Challenge", tashmë ka siguruar një stabilitet për tri vitet pasi që ka mbështetur e Agjencionit Austriak të Kooperimit deri në 2010. Këtë vit "KCC"-ja do të përbëhet nga tri pjesë: Trainimi për aplikues lidhur me Garën e Rastit Studimor, gara, ku fituesit nga çdo disiplinë do të selektohen për BCC-në, që do të mbahet në Vjenë dhe Ngjarja e Rekrutimit. Dedaj tha se në Kosovë rreth 50

prezantimit, trajnimit për shkruarjen e CV-së, sjellja në intervistë si dhe trajnim për të përgatitur studentët në disiplinat garuese. Këta participues do të garojnë në këto disiplina: Stimulimi i Gjyqit, Gara e Rastit të Biznesit, Modeli i Këshillit të Evropës dhe Gara e Rastit të Teknologjive Informative dhe Komunikuese. Kurse, kandidatët e këtij projekti duhet të jenë studentë të shkëlqyer dhe që janë në përfundim të studimeve në fushën ekonomikut, juridikut, shkencave politike, nga mbarë vendet e

participuesitë kualifikohen me një procedurë rigorozë të seleksionimit duke u bazuar në performancën e tyre akademike, aktivitetet jashtë mësimore si dhe të jetë i rrjedhshëm në gjuhën angleze dhe gjermane. Afati i aplikimit ka filluar më 18 janar dhe do të zgjasë deri më 31 mars, kurse të drejtë konkurrimi kanë të gjithë studentet e UP-së dhe Universiteteve private në Kosovë, por që janë të licencuar nga MASHT-i. Në mënyrë që të forcohen lidhjet në mes të edukimit të lartë dhe punësimit,

dyfishta do të prezantohen Panairi i Punës në BCC Vjena dhe Ngjarjet e Rekrutimit në gjysmë finale. Me anë të këtij programi, WUS Austria, ofron mundësi kompanive, institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare që të bëhen partnere në mënyra të ndryshme, mbështetje financiare, mënyra tjera, praktike, trainime, libra, bursa, hapësirë për implementimin e garës, produkte etj. "Rasti

# RASTI SFIDUES, EKONOMIKU MË I INTERESUARI

**W**US-Austria, Zyra në Prishtinë, ftoi të enjten studentët kosovarë që të aplikojnë për programin "Kosova Case Challenge 2008" (Rasti sfidues i Kosovës 2008), me ç'rast studentët fitues të kësaj gare do të mundë të marrin pjesë në finalen e madhe "Balkan Case Challenge", që do të mbahet me 6-11 korrik në Vjenë. But Dedaj, drejtor i WUS-Austria, Zyrës në Prishtinë, tha se programi "Kosova Case Challenge 2008" është një sfidë për studentët kosovarë që dijen e tyre teorike ta zbatojnë edhe në praktikë. Ai tha se "Rasti sfidues i Kosovës" synon në hapjen e mundësive dhe perspektivave të reja studentëve të shkëlqyer të edukimit të lartë të Kosovës, duke i forcuar lidhjet në mes edukimit të lartë dhe punësimit, si dhe ofrimin e shanseve konkrete për punë. Duke shpjeguar programin e projektit, ai tha se gara studimore, e bazuar në metodën e rastit studimor, zhvillohet në katër disiplina: rasti biznesit, që përfshin studentët e të gjitha fushave të ekonomikut; teknologjia informa-



tive dhe komunikuese, që përfshin studentët e shkencave teknike; modeli i Keshillit të Evropës, që përfshin studentët e shkencave politike, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, sociologji etj dhe rasti i katërt është simullmi i gjyqit, e që do të përfshijë studentët e juridikut. Dedaj, shpjegoi se kësaj here ky program ka disa objektiva: kompanive të ndryshme t'u ofrojë studentë të shkëlqyer në mënyrë që t'i punësojë

ata si kuadër, pastaj kompanitë problemet e ndryshme të tyre të mund t'i zgjidhin nga studentët të cilët konkurrojnë, mundësia që kompanitë të ofrojnë bursa për studentë, krijimi i rrjetit të komunikimit në region etj. Kësaj radhe, gara "Kosova Case Challenge 2008" do të përbëhet nga tri pjesë: trajnimi për aplikues lidhur me garën e rastit studimor, gara ku fituesit nga çdo disiplinë do të selektohen për garën "Balkan Case

Challenge", që do të mbahet në Vjenë dhe ngjarja e rekrutimit. Koordinatorja e projektit, Mjellma Carabregu, tha se interesimi më i madh për këtë garë është i studentëve të ekonomikut, ndërsa afati i konkurrimit ka filluar që nga 18 janari dhe do të vazhdojë deri më 31 mars, ndërsa gara në Kosovë do të mbahet gjatë periudhës 10-11 maj, ku fituesit do të kualifikohen direkt për finalen ndërkombëtare që do të mbahet me 6-11 korrik 2008, në Vjenë. "Kosova Case Challenge 2008", organizohet për herë të katërt, ndërsa nga 50 studentët që do të jenë në listën e ngushtë, 8-10 prej tyre do të arrijnë të marrin pjesë në garën e Vjenës. Këtë vit "Balkan Case Challenge, prezanton gjysmëfinalen në 11 vende të Evropës Juglindore, duke e vazhduar traditën e saj në Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë dhe Serbi, ndërsa është duke u organizuar për herë të parë në Maqedoni, Mal të Zi, Moldavi, Bullgari, Kroaci, Rumani, Slloveni, si dhe në Austri.

**B. SALIHU**

# Rasti i studentëve...

**Prishtinë, 7 shkurt** - WUS-Austria, Zyra në Prishtinë, ka ftuar të enjten studentët kosovarë që të aplikojnë për programin "Kosova Case Challenge 2008" (Rasti sfidues i Kosovës 2008), me ç'rast studentët fitues të kësaj gare do të mund të marrin pjesë në finalen e madhe "Balkan Case Challenge", që do të mbahet më 6-11 korrik në Vjenë.

But Dedaj, drejtor i WUS-Austria, Zyrës në Prishtinë, ka thënë se programi "Kosova Case Challenge 2008", është një sfidë për studentët kosovarë që dijen e tyre teorike ta zbatojnë edhe në praktikë.

Ai ka thënë se "Rasti sfidues i Kosovës" synon rë hapjen e mundësive dhe perspektivave të reja studentëve të shkëlqyer të Edukimit të Lartë të Kosovës duke i forcuar lidhjet ndërmjet edukimit të lartë dhe punësimit si dhe ofrimin e shanseve konkrete për punë.

Duke shpjeguar programin e projektit, ai ka thënë se gara studimore e bazuar në metodën e rastit studimor zhvillohet në katër disiplina: rasti biznesor që përfshin studentët e të gjitha fushave të ekonomikut; teknologjia informative dhe komunikuese që përfshin studentët e shkencave teknike; modeli i Këshillit të Evropës që përfshin studentët e shkencave politike, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, sociologji etj.; dhe rasti i katërt është simulimi i gjyqit e që do të përfshijë studentët e juridikut.

Dedaj ka thënë se këtë herë ky program ka disa objektiva: kompanive të ndryshme t'iu ofrojë studentë të shkëlqyer në mënyrë që t'i punësojë ata si kuadër, pastaj kompanitë problemet e ndryshme të tyre të mund t'i zgjedhin nga studentët të cilët konkurrojnë, mundësia që kompanitë të ofrojnë bursa për studentë, krijimi i rrjetit të komu-



nikimit në regjion etj.

Sipas tij, nga praktikata e viteve të kaluara, studentët kosovarë kanë treguar mjaft rezultate të larta, mirëpo, sipas tij, ende është larg përgatitja e tyre gjatë studimeve për tregun e punës.

Për këtë arsye, këtë herë gara "Kosova Case Challenge 2008" do të përbëhet nga tri pjesë: trajnimi për aplikues lidhur me garën e rastit studimor, gara ku fituesit nga çdo disiplinë do të selektohen për garën "Balkan Case Challenge", që do të mbahet në Vjenë dhe ngjarja e rekrutimit.

Koordinatorja e projektit, Mjellma Carabregu, ka thënë se interesimi më i madh për këtë garë është i studentëve të ekonomikut, ndërsa afati i konkurrimit ka filluar që nga 18 janari dhe do të vazhdojë deri më 31 mars, ndërsa gara në Kosovë do të mbahet gjatë periudhës 10-11 maj, ku fituesit do të kualifikohen direkt për finalen ndërkombëtare që do të mbahet më 6-11 korrik 2008, në Vjenë.

"Kosova Case Challenge 2008", organizohet për herë të katërt, ndërsa nga 50 studentët që do të jenë në listën e ngushtë, 8-10 prej tyre do të arrijnë të marrin pjesë në garën e Vjenës.

Carrabregu duke treguar procedurat e konkurrimit, ka thënë se studentët që aplikojnë duhet të vërtetojnë se janë studentë të vitit të caktuar, duhet ta njohin gjuhën angleze, ndërsa preferohet të jenë student të vitit të fundit të studimeve themelore ose student në nivelin Master, mirëpo, sipas saj, nuk do të përjashtohen as edhe studentë në vitet e para të studimeve.

Këtë vit Balkan Case Challenge prezanton gjysmëfinalen në 11 vende të Evropës Juglindore duke e vazhduar traditën e saj në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Serbi, ndërsa është duke u organizuar për herë të parë në Maqedoni, Mal të Zi, Moldavi, Bullgari, Kroaci, Rumani, Slloveni, si dhe në Austri. (ksl)

## Peja formon këshillin për festimin e pavarësisë

**Pejë, 7 shkurt** - Drejtuesit e Kuvendit Komunal (KK) të Pejës, së bashku me policinë rajonale të Pejës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) në Dukagjin, organizatat e dala nga lufta e Ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe subjekteve politike në këtë qytet, kanë formuar të enjten këshillin organizativ për festimin e ditës së pavarësisë.

Këshilli i formuar, siç ka njoftuar zyra për informim e KK të Pejës, do ta drejtojë kryetari i

Pejës, Ali Berisha, ndërsa pjesë përbërëse e tij do të jenë edhe përfaqësuesit e policisë, TMK-së, shoqatave të dala nga lufta dhe subjekteve politike.

Në takimin e ardhshëm, që mendohet të mbahet pas tre-katër ditësh, këshilli do ta miratojë programin e ditës së kremtimit të pavarësisë dhe do t'i caktojë bartësit dhe pjesëmarrësit e manifestimit, i cili planifikohet të mbahet në qendër të qytetit. (ksl)

NGA WUS-AUSTRIA

## RASTI SFIDUES I KOSOVËS ËSHTË GARA MË E MADHE STUDENTORE NË VEND

Prishtinë, 7 shkurt

Të enjten është mbajtur një konferencë për media e organizuar nga WUS-Austria në lidhje me projektin "Rasti Sfidues i Kosovës-Kosova Case Challenge". Rasti Sfidues i Kosovës është gara më e madhe studentore në vend, që në të njëjtën kohë është gjysmë finale për finalen ndërkombëtare Balkan Case Challenge. Gara studentore e bazuar në metodën e rastit studimor zhvillohet në këto katër raste: rasti biznesor, teknologjia informative dhe komunikuese, Modeli i Këshillit të Evropës dhe simulimi i gjyqit (studentët e juridikut). Studentët më të mirë do të shpërblehen me praktika, trajnime libra si dhe kompanitë pjesëmarrëse do rekrutojnë disa nga studentët më të mirë. Fituesit e garës do të marrin pjesë në finalen e madhe Balkan Case Challenge 2008 në Vjenë. But Dedaj, drejtor i WUS-Austria, tha se Balkan Case Challenge prezenton këtë vit gjysmëfinale në 11 vende të Evropës Juglindore, duke e vazhduar traditën e saj në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi, dhe duke u organizuar për herë të parë në Maqedoni, Mal të Zi, Moldavi, Bullgari, Kroaci, Rumani, Slloveni si dhe në Austri. Dhe në çdo shtet projekti vetëm merr parashtesën e vendit në vend në Ballkan. "Në këtë rast kemi edhe Kosova Case Challenge apo Rasti Sfidues i Kosovës që përfaqëson gjysmë finale për Balkan Case Challenge. Kosova Case Challenge 2008 është organizuar këto tri vitet e fundit, që nga viti 2004. KCC 2008 do të organizohet në një dimension pak më ndryshe se herëve të kaluara", -pohoi But Dedaj. Ai tha se Rasti Sfidues i Kosovës synon në hapjen e mundësive dhe perspektivave të reja studentëve të shkëlqyer të Edukimit të Lartë të Kosovës duke i forcuar lidhjet në mes të Edukimit të Lartë dhe punësimit si dhe me ofrimin e shanseve konkrete për punë. Ndërkaq, Rasti Sfidues i Ballkanit kontribuon që të rrit vetëdijen për potencialin që posedon Evropa Juglindore dhe Ballkani duke qenë pjesë e Evropës. Grupe të synuara të projektit janë student. "Rasti Sfidues i Ballkanit 2008 - 2010 fokusohet në institucionalizimin dhe standardizi-

min e BCC si një mjet i qëndrueshëm për lidhjen e Edukimit të Lartë dhe Punësimit me një fokus në Evropën Juglindore", -pohoi Dedaj, duke shtuar se kjo përfshinë një standard të lartë të garës dhe participantëve, një aspekt intensiv i punësimit dhe rekrutimit, sigurimi i mundësive konkrete të karrierës për participantët dhe pjesëmarrësit e viteve të kaluara, rrjetëzimi i të gjitha palëve të involvuara dhe një pjesëmarrje e përmirësuar e partnerëve dhe kompanive nga Evropa Juglindore dhe Austria, tha ai. But Dedaj shtoi se Kosova Case Challenge tashmë ka siguruar një stabilitet për tri vitet pasi që ka mbështetjen e Agjencisë Austriake të Kooperimit deri në 2010. "Në Kosovë rreth 50 participantë do të trajnohen në përmirësimin e aftësive të prezantimit, trajnimit për shkruarjen CV-së, sjellja e intervistë si dhe trajnim për ti përgatitur studentët në disiplinat garuese. Participantët garojnë në këto disiplina: Simulimi i Gjyqit është një simulim tradicional i gjyqit, ku studentët përgatisin zgjidhjen e problemit që ka të bëjë me ndonjë problem specifik të së Drejtës Ndërkombëtare", -theksoi Dedaj, duke shtuar se gara e Rastit të Biznesit sjell së bashku studentët më të mirë të biznesit, menaxhmentit, ekonomisë. Rastet studimore në këtë garë kanë të bëjnë me klimën biznesore dhe të zhvillimit ekonomik në Evropën Juglindore, tha ai. Drejtori i WUS-Austria tha se modeli i Këshillit të Evropës duke filluar nga ky vit zëvendëson modelin e Kombeve të Bashkuara të viteve të kaluara. Modeli i Këshillit të Evropës është një simulim autentik i Këshillit të Evropës i cili nuk është një trup legjislativ, mirëpo diskuton çështjet më urgjente si dhe negociacionin pozitiv të Unionit Evropian në raste të tilla si dhe jap udhëzime të përgjithshme sociale, ekonomike dhe politike në të gjitha fushat e aktiviteteve të Unionit Evropian. Gara e Rastit në Teknologjinë Informative dhe Komunikuese simulon implementimin e TIK-së në ambiente biznesore. Pjesëmarrësit duhen që të analizojnë procesin biznesor dhe infrastrukturën e kompanisë si dhe të sugjerojnë një zgjidhje.

Ismail Shabani

Studentët nga Kosova do të marrin pjesë në garën studimore në Austri

# Dija peshohet në Vjenë

Prishtinë, 7 shkurt - Për herë të katërt në Kosovë, me mbështetjen e Agjencisë Austriake të Kooperimit, organizata për edukim "Wus-Austria" e organizon garën studimore "Rasti Sfidues i Kosovës 2008". Për dallim nga viti i kaluar, kësaj radhe kjo garë do të përbëhet nga tri pjesë - trajnimi për aplikues, ku fituesit nga çdo disiplinë do të selektohen për "Rastin Sfidues të Ballkanit", që do të mbahet në Vjenë, dhe ngjarja e rekrutimit (punësimit). Gara do të zhvillohet në katër disiplina garuese -

simulim gjyqi, biznes, modeli i Këshillit të Evropës që zëvendëson modelin e Kombeve të Bashkuara të viteve të kaluara dhe në teknologjinë informative dhe komunikuese.

Drejtori i "Wus-Austria", But Dedaj, tha se të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e arsimit të lartë në Kosovë që ndodhen në vitin e fundit të studimeve apo i vijojnë studimet master. Por, sipas tij, nuk u mohohet e drejta e konkurrimit as studentëve të viteve paraprake që kanë sukses të dalluar dhe e njohin gjuhën angleze, e

cila është kriter për pjesëmarrje në këtë garë. "Kjo është një sfidë për studentët tanë që dijen e fituar në teori ta zbatojnë edhe në praktikë me raste konkrete, si dhe të vlerësohet se sa janë të përgatitur për t'u përballur me tregun e punës". Dedaj tha se këtë herë do të përdoret edhe një metodë e re. "Nga përfaqësues të kompanive private e publike që janë partnerë në organizimin e kësaj gare, studentëve garues do t'u prezantohet një problem i cilësdo kompani dhe gjatë dy ditëve ata do të kenë rast

të japin idenë e tyre se si do të dilet nga problemi, gjë që do të ndikojë pozitivisht në punësimin e tyre në atë kompani apo mbulimin e studimeve master". Aplikimi do të zgjasë deri më 31 mars, ndërkohë studentët mund të aplikojnë nëpërmjet adresës elektronike të kësaj organizate. Juria, e cila do të bëjë përzgjedhjen e tyre, do të përbëhet nga gjyqtarë, prokurorë, biznesmenë dhe ekspertë të lëmenjve përkatës. Gara do të mbahet më 10 dhe 11 maj. (a. kadriu)

"LAJM" - 08.02.2008 pg. 8

Studentët nga Kosova do të marrin pjesë në garën studimore në Vjenë

## "Rasti sfidues i Kosovës 2008" këtë vit sjell risi

Është një sfidë për studentët tanë që dijen e fituar në teori ta zbatojnë edhe në praktikë me raste konkrete, si dhe të vlerësohet sesa janë ata të përgatitur për t'u përballur me tregun e punës, tha But Dedaj, drejtor i organizatës "Vus-Austria"

### Besa Bytyçi

Organizata për edukim "Vus Austria", për herë të katër këtë vit, organizon garën "Rasti sfidues i Kosovës 2008" me mbështetjen e Agjencisë Austriake të Kooperimit.

But Dedaj, drejtor i "Vus-it" tha se të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e arsimit të lartë në Kosovë që ndodhen në vitin e fundit të studimeve, apo vijnë studimet master. Por, sipas tij, nuk iu mohohet e drejta e konkurrencës as studentëve të

viteve paraprake që kanë sukses të dalluar dhe njohin gjuhën angleze, e cila është kriter për pjesëmarrje në këtë garë. "Kjo është një sfidë për studentët tanë që dijen e fituar në teori ta zbatojnë edhe në praktikë me raste konkrete si dhe të vlerësohet sesa janë ata të përgatitur për t'u përballur me tregun e punës".

Dedaj bëri të ditur se këtë herë do të përdoret dhe një metodë e re. Sipas tij, nga përfaqësues të kompanive private e publike që janë partner në organizimin e kësaj gare, studentëve garues do t'u prezantohet një problem i cilës-

do kompani dhe gjatë dy ditëve studentët do të kenë rast të japin idenë e tyre se si do të dilet nga problemi. "Kjo gjë do të ndikojë pozitivisht në punësimin e tyre në atë kompani apo mbulimin e studimeve master", tha ai.

Për dallim nga viti i kaluar, kësaj radhe kjo garë do të përbëhet nga tri pjesë: trajnimi për aplikues, gara ku fituesit nga çdo disiplinë do të selektohen për rastin sfidues të Ballkanit që do të mbahet në Vjenë dhe ngjarja e rekrutimit (punësimin). Ndërkaq gara do të zhvillohet në katër disiplina garuese; simulim gjyqi, biznes, mod-

eli i Këshillit të Evropës që zëvendëson modelin e Kombeve të Bashkuara të viteve të kaluara dhe në teknologjinë informative dhe komunikuese.

Aplikimi do të zgjasë deri më 31 mars, ndërkohë studentët mund të aplikojnë përmes adresës elektronike të kësaj organizate. Juria, e cila do të bëjë përzgjedhjen e tyre, do të përbëhet nga gjyqtarë, prokurorë, biznesmen dhe ekspertë të lëmenjve përkatës.

Gara do të mbahet më 10-11 maj. ■

"ZËRI" - 08.02.2008. fq. 8

# PROGRAMI "TEMPUS", 30 PROJEKTE PËR UP-në

NACIONALE E ETJE 7 SHKURT 2008

UP-ja, nga gjithsej 30 projekte të përfituar në kuadër të programit "Tempus", 11 vlerësohet të jetë duke i zbatuar, prej tyre zhvillimi i programit për "Interpretim", "Shoqëria civile dhe zhvillimi lokal" si dhe "Mësimi në distancë"

Leonora Shala  
Qëndresa Simnica

Prishtinë 6 shkurt - Universiteti i Prishtinës, në kuadër të Programit Komisionit Evropian "Tempus", nga gjithsej 30 projekte të përfituar, 11 vlerësohet të jetë duke i zbatuar, prej tyre zhvillimi i programit për "Interpretim", "Shoqëria civile dhe zhvillimi lokal" si dhe "Mësimi në distancë", në nivelin Master të studimeve, janë cilësuar të rëndësishme. Në një konferencë për media u tha se me gjithë dobësitë në UP, problemit të pozitës së mësimdhënësve në arsimin e lartë dhe pranisë së gjerë të sektorit privat, i cili nuk lejon hapësirë për përkushtim të lartë në projekte konkrete, është duke i kushtuar rëndësi bashkëpunimit me universitetet evropiane dhe ka pika pozitive që mund të shihen. Suzana Manxhuka-Kërliu, prorektore në UP, duke sqaruar fazat në të cilat ndodhen tri projektet e cilësuar si shumë të rëndësishme tha se "Projekti për Interpretim është një projekt i cili është në fazën

te kurrikulës së re në interpretim si dhe do të kemi formimin e një Qendre për interpretim e cila do të ketë për synim arritjen e një cilësie të mësimi të gjuhëve të huaja", tha Manxhuka-Kërliu. Ndërsa, për projektin "Shoqëria civile dhe zhvillimi lokal", ajo tha se ky është projekt më i avancuar, ku janë përzgjedhur studentët nga një konkurrencë shumë e lartë dhe pritet që mësimi të fillojë javën e ardhshme. Partnerë në këtë program është Universiteti Goldëay dhe i ai i Gracit. Me gjithë kushtet e rënda me të cilat përballlet UP-ja, edhe në formën klasike të mësimi në nivelin Master të studimeve, Profektoria theksoi se UP-ja mund të mburret me zgjerimin e mëtejme të projektit "Mësimi në distancë-elektronik". Ajo vlerësoi se kjo është formë më e sofistikuar e mësimdhënies për të cilën ka pasur trajnime për stafin administrativ, ndërsa do të vazhdohen edhe për stafin akademik dhe për vetë studentët. Sipas saj, në përgjithësi programi "Tempus", ka ndihmuar shumë UP-në, si në procesin e reformimit edhe në



rin pjesë edhe Universiteti i Lubjanës, Milanos, Napolit, pastaj edhe ekspertë individual nga Shqipëria e Gjermania, ka si qëllim kryesor themelimin e një qendre për gjuhë të huaja. Kjo qendër, sipas tij, përveç që do t'iu mësojë gjuhë të huaja studentëve, ai do të synojë të jetë i hapur edhe për të tjerë jashtë universitetit, i cili synon të zhvillojë atë që, sipas tij, quhet mësim gjatë gjithë jetës. Si qëllim tjetër të këtij programi, Hotcel përmendi formimin

që ajo koordinon është duke u zbatuar nga UP-ja. "Ky projekt përfshinë Fakultetin e Shkencave politike, Sociologjisë dhe të Ekonomikut", tha Istrefi duke shtuar se ka për qëllim që për tre vite të dalin ekspertë të zhvillimit lokal. Ajo tha se mësimi në këtë program i cili është për nivelin Master të studimeve, do të fillojë javën e ardhshme, ku vijues do të jenë 17 studentë. Sipas saj, të gjitha përgatitjet janë bërë, ndërsa

ndërsa tani projekti i cili është zhvilluar në vazhdimësi tenton të shtrihet tani në tërë UP-në. "Objektiv i këtij projekti janë që shtatë lende mësimore t'iu ofrohen studentëve në formë elektronike, ndërsa për këtë parashihen të mbahen trajnime për personelin administrativ, për atë akademik dhe për vet studentet", tha Dedaj. Ai theksoi se trajnimi për administratë tashmë është kryer, ndërsa i dyti do të fillojë në vikendin e ardhshëm, i cili me tre ditë trajnim, parashikon të aftësojë stafin akademik me këtë mënyrë studimi. Ndërsa, për trajnimin e tretë i cili referohet për studentë, thuhet të bëhet pasi të lëshohet qendra e telekonferencës, e cila pretendohet të bëhet pas dy muajve. Se sa është e përgatitur UP-ja për këtë mënyrë të mësimi kur dihet që, edhe mësimi klasik në nivelin Master të studimeve, nuk është duka vajtur mirë, Dedaj tha se "Mësimi në distancë ka qenë frikësues edhe për universitet e regjionit e është edhe për personelin në UP, mirepo nuk mund të them se nuk kemi të kënësuar me



# UP përfiton 30 projekte

**K**uqulla më e vjetër, që është zbuluar deri më tash, është e moçme 1800 vjet. Këtë lodër e kanë gjetur arkeologët që në vitin 1889 në një varr të vjetër romak dhe që atëherë kjo jeton në muze.

♦ "Programi 'TEMPUS', ka ndihmuar shumë UP-në, si në procesin e reformimit ashtu edhe në zhvillimin e planprogrameve të reja dhe atyre ekzistuese", ka thënë Suzana Manxhuka - Kërliu, prorektore në Universitetin e Prishtinës

INFO PRESS - 07.02.2008 - Pg 12

## Shqipe Dervishaj PRISHTINË, 6 SHKURT

**U**niversiteti i Prishtinës, nga gjithsej 30 projekte të përfituar në kuadër të programit TEMPUS, vlerësohet të jetë duke i zbatuar 11 sosh.

Prorektorja Suzana Manxhuka - Kërliu, prezantoi sot tri projekte të studimeve Master për zhvillim të kurrikulumit, shoqërisë civile dhe zhvillimit lokal. Ndërkaq, shelja e zyrës së Tempus-it, Lindita Tahiri, ka thënë se Universiteti i Prishtinës po bën përpjekje për rritjen e bashkëpunimit me universitetet evropiane.

### "Qendra për interpretim"

Duke sqaruar fazat në të cilat ndodhen tri projektet e cilësura si shumë të rëndësishme, Suzana Manxhuka - Kërliu, prorektore në Universitetin e Prishtinës, ka thënë se projekti për "Interpretim" është në fazën fillestare të zbatimit dhe Universiteti i Strasburgut është grant mbajtës i tij. "Është projekt shumë i rëndësishëm nga i cili UP-ja përfiton shumë sepse do të themelohet një studim Master, do të ketë një zhvillim të kurrikulës së re në interpretim si dhe do të kemi formimin e një Qendre për Interpretim që do të ketë për synim arritjen e një cilësie të mësimt

të gjuhëve të huaja", ka thënë Manxhuka-Kërliu.

Kurse sa i përket projektit "Shoqëria civile dhe zhvillimi lokal", ajo tha se ky është projekt më i avancuar, ku janë përzgjedhur studentët nga një konkurrencë shumë e lartë dhe pritet që mësimi të fillojë javën e ardhshme. Sipas saj, partnerë në këtë program janë Universiteti Goldway dhe Universiteti i Gracit. Manxhuka Kërliu theksoi se UP-ja mund të mburret me zgjerimin e projektit "Mësimi në distancë-elektronik". Ajo vlerësoi se kjo është formë më e sofistikuar e mësimdhënies për të cilën ka pasur trajnime për stafin administrativ, ndërsa do të vazhdohen edhe për stafin akademik dhe për vet studentët.

"Programi 'TEMPUS', ka ndihmuar shumë UP-në, si në procesin e reformimit ashtu edhe në zhvillimin e plan programeve të

reja dhe atyre ekzistuese", shtoi Manxhuka- Kërliu.

### Lëndët mësimore në formë elektronike

"Programi 'Shoqëria civile dhe zhvillimi lokal', është duke u zbatuar nga UP, përfshin Fakultetin e Shkencave politike, Sociologjisë dhe të Ekonomikut dhe ka për qëllim që për tri vite të nxjerr ekspertë të zhvillimit lokal", ka thënë Remzije Istrefi, koordinatore e këtij projekti. Ajo ka thënë se mësimi në këtë program që është i nivelit Master të studimeve do të fillojë javën e ardhshme ku vijues do të jenë 17 studentë. Sipas saj, të gjitha përgatitjet janë bërë, ndërsa ligjëruesit do të jenë vendorë dhe ndërkom-bëtarë.


Ndërsa But Dedaj, koordinator i projektit për "Mësim në dis-

tancë", ka thënë se një projekt i tillë ka filluar para katër viteve "njësia operuese për mësim elektronik në UP", ndërsa tani projekti është zhvilluar në vazhdimësi tenton të shtrihet në tërë UP-në. "Objektiv i këtij projekti është që shtatë lëndë mësimore t'iu ofrohen studentëve në formë elektronike, ndërsa për këtë parashihen të mbahen trajnime për personelin administrativ, për atë akade-

mik dhe për studentët", ka thënë Dedaj. Ai njoftoi se trajnimi për administratë tashmë është kryer, ndërsa i dyti do të fillojë në vikendin e ardhshëm, i cili me tri ditë trajnim parashikon të aftësojë stafin akademik me këtë mënyrë studimi. Ndërsa, për trajnimin e tretë i cili referohet për studentë thuhet të bëhet pasi të lëshohet qendra e telekonferencës, e cila pretendohet të bëhet pas dy muajve.

### Qendra për gjuhë të huaja, synim kryesor

"Projekti për zhvillimin e programit për "Interpretim", në të cilën pjesëmarrës janë edhe Universiteti i Lubjanës, Milanos, Napolit, ekspertë individual nga Shqipëria e Gjermania, ka qëllim kryesor themelimin e një qendre për gjuhë të huaja", ka thënë Eckhart Hotzel, nga Universiteti i Strasburgut. Kjo qendër, sipas tij, përveç që do t'iu mësojë gjuhë të huaja studentëve, ai do të synojë të jetë i hapur dhe për të tjerë jashtë universitetit, i cili synon të zhvillojë atë që sipas tij quhet mësim gjatë gjithë jetës. Po ashtu pjesë të këtij programi, ai theksoi formimin e një programi në nivelin Master të studimeve për përkthyes dhe interpret, i cili do të jetë për mësimin praktik profesional të përkthimit.



## [WUS Austria fton studentët për garën "Rasti sfidues i Kosovës 2008"](#)

07.02.2008 13:08 ET Prishtinë (KosovaLive)

WUS-Austria, Zyra në Prishtinë, ftoi të enjten studentët kosovarë që të aplikojnë për programin "Kosova Case Challenge 2008" (Rasti sfidues i Kosovës 2008), me ç'rast studentët fitues të kësaj gare do të mund të marrin pjesë në finalen e madhe "Balkan Case Challenge", që do të mbahet me 6-11 korrik në Vjenë.

But Dedaj, drejtor i WUS-Austria, Zyrës në Prishtinë, tha se programi "Kosova Case Challenge 2008", është një sfidë për studentët kosovarë që dijen e tyre teorike ta zbatojnë edhe në praktikë.

Ai tha se "Rasti sfidues i Kosovës" synon në hapjen e mundësive dhe perspektivave të reja studentëve të shkëlqyer të Edukimit të Lartë të Kosovës duke i forcuar lidhjet në mes edukimit të lartë dhe punësimit si dhe ofrimin e shanseve konkrete për punë.

Duke shpjeguar programin e projektit, ai tha se gara studimore e bazuar në metodën e rastit studimor zhvillohet në katër disiplina: rasti biznesor që përfshin studentët e të gjitha fushave të ekonomikut; teknologjia informative dhe komunikuese që përfshin studentët e shkencave teknike; modeli i Këshillit të Evropës që përfshin studentët e shkencave politike, marrëdhënie ndërkombëtare, diplomaci, sociologji etj dhe rasti i katërt është simulimi i gjyqit e që do të përfshijë studentët e juridikut.

Dedaj, shpjegoi se kësaj here ky program ka disa objektiva: kompanive të ndryshme t'iu ofrojë studentë të shkëlqyer në mënyrë që t'i punësojë ata si kuadër, pastaj kompanitë problemet e ndryshme të tyre të mund t'i zgjedhin nga studentët të cilët konkurrojnë, mundësia që kompanitë të ofrojnë bursa për studentë, krijimi i rrjetit të komunikimit në regjion etj.

Sipas tij, nga praktikat e viteve të kaluara, studentët kosovar kanë treguar mjaft rezultate të larta, mirëpo sipas tij, ende është larg përgatitja e tyre gjatë studimeve për tregun e punës.

Për këtë arsye, kësaj radhe gara "Kosova Case Challenge 2008", do të përbëhet nga tri pjesë: trajnimi për aplikues lidhur me garën e rastit studimor, gara ku fituesit nga çdo disiplinë do të selektohen për garën "Balkan Case Challenge", që do të mbahet në Vjenë dhe ngjarja e rekrutimit.

Koordinatorja e projektit, Mjellma Carabregu, tha se interesimi më i madh për këtë garë është i studentëve të ekonomikut, ndërsa afati i konkurrimit ka filluar që nga 18 janari dhe do të vazhdojë deri më 31 mars, ndërsa gara në Kosovë do të mbahet gjatë periudhës 10-11 maj, ku fituesit do të kualifikohen direkt për finalen ndërkombëtare që do të mbahet me 6-11 korrik 2008, në Vjenë.

"Kosova Case Challenge 2008", organizohet për herë të katërt, ndërsa nga 50 studentët që do të jenë në listën e ngushtë, 8-10 prej tyre do të arrijnë të marrin pjesë në garën e Vjenës.

Carrabregu duke treguar procedurat e konkurrimit tha se studentët që aplikojnë duhet të vërtetojnë se janë studentë të vitit të caktuar, duhet ta njohin gjuhën angleze, ndërsa preferohet të jenë student të vitit të fundit të studimeve themelore ose student në nivelin Master, mirëpo sipas saj nuk do të përjashtohen as edhe studentë në vitet e para të studimeve.

Këtë vit Balkan Case Challenge prezanton gjysmëfinalen në 11 vende të Evropës Juglindore duke e vazhduar traditën e saj në Kosovë, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe

Serbi, ndërsa është duke u organizuar për herë të parë në Maqedoni, Mal të Zi, Moldavi, Bullgari, Kroaci, Rumani, Slloveni, si dhe në Austri./b.salihu/